



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Nr.01-060/01-1545/20 datë:20.01.2020



Npi – 01/62 datë: 27.02.2020

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 të datës: 31.05.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.02.2020 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -II- TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES

E mbajtur më: 27.02.2020, e (enjte) në ora 10.⁰⁰ h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Medina Brahaj, Perparim Ramusa, Shefki Dauti, Herolind Selmani, Reshat Mujota, Arbresha Syla, Milot Deliu, Fatmire Ferati, Naim Zejna, Skender Hyseni, Zarife Rexhaj, Valentina Halili-Ferati, Ruzhdi Jashari, Besnik Seferi, Marigona Pajaziti, Fehmi Hysenaj, Adelina Beqaj, Isak Muslija, Diarta Vishesella, Muhamet Ademaj, Rexhep Gashi.

Përveç delegatëve në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi, Drejtorët; Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Ardita Ndrecaj; Zyrtari për barazi gjinore, z.Reshat Gashi; Zyrtari Ligjor z.Lulzim Muharremi; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Përgjegjësi i ZKKK-së, z.Ibrahim demiri; Përfaqësuesi i OSBE-së, z.Mefail Mustafa; Përfaqësuesit e KFOR-it me përkthyesin; Zyrtarët e IT-së Gazmend Ademaj dhe Shpëtim Gashi.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar mbledhjen. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 30.01.2020,
2. Pyetje – Përgjigje,
3. Rishqyrtimi i Ligjshmërisë të Rregullores Komunale për Taksa, tarifa dhe Gjoha sipas MAPL-së,
4. Draft-Programi Komunal për banim për periudhën 2020-2022,
5. Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve,
6. Lista e kërkesave,
7. Propozim-Plani i Punës së KKS-së për vitin 2020. (Pikë Shtesë)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, Nënkryetari, Rrahman Jakupi, ka propozuar që të futet edhe një pikë shtesë e rendit të ditës “Propozim-Plani i Punës së KKS-së për vitin 2020”. Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Rexhep Gashi; Përshëndetje, unë propozoj që sot ta fusim në rendin e ditës një pikë shtesë që të marrim vendim për ditën e diele, që të jetë ditë pushimi për të gjithë në Komunën e Shtimes.

z.Fehmi Hysenaj; Përshëndetje, materialin e kemi marrë me kohë. Unë kam një propozim që pika e 5 të hiqet nga rendit të ditës, sepse nëse rekomandimet e Auditorit të përgjithshëm janë plotësuar siç po thuhet, atëherë ne nuk kemi arsye që të debatojmë për këtë pikë. Te pika e 6 “Lista e Kërkesave” unë po kërkoj që lidhur me Kërkesën e z.Bahri Rexhaj – Petrovë, të plotësohet me informacione shtesë siq

janë psh. Hartat, Orto-Foto me na i sjellë në Kuvend që ne delegatët të shohim qartë se për cilat parcela po bëhet fjalë.

znj.Marigona Pajaziti; Përshëndetje, Unë propozoj që të futet si pikë shtesë e rendit të ditës edhe formimi i një Komisioni për ndryshimin e Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Studentë.

z.Shefki Dauti; Përshëndetje, sa i përket ditës së diel që u propozua të vendoset si ditë pushimi, unë nuk jam që kjo të futet në rendin e ditës me arsyetimin se ne nuk jemi të përgatitur për këtë pikë edhe as nuk kemi ndonjë material të shkruar. Ne fillimisht këtë çështje duhet që ta diskutojmë me bizneset e pastaj të marrim vendim. Unë e përkrahu propozimin që e dha Marigona Pajaziti që të futet në rend dite formimi i një Komisioni për ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave për Studentë.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, sa i përket propozimeve që po bëhen për rendin e ditës ne duhet ta dimë se Rregullorja e Punës së Kuvendit e përcakton saktë mënyrën e futjes së pikave shtesë në rendin e ditës, prandaj i ftoj kolegët që propozimet ti japin duke u bazuar në këtë rregullore. unë e përkrahu propozimin e Marigona Pajazitit që të futet në rend dite formimi i një Komisioni për ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave për Studentë.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës edhe me propozimin që e ka dhënë Nënkryetari për pikën shtesë. Ndërsa propozimet tjera unë jam që të shtyhen deri në mbledhjen e radhës së Kuvendit. E përkrahu po ashtu edhe propozimin e Fehmi Hysenaj që kërkoi që për kërkesën e z.Bahri Rexhaj nga Petrova, të plotësohet me informacione shtesë siç janë psh. Hartat, Orto-Foto, etj.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, rendi i ditës që është propozuar është i pranuar për ne, edhe pika shtesë e propozuar që ka të bëjë me aspektin e sigurisë në komunën tonë për ne është e pranuar dhe do ta votojmë, sepse aspekti i sigurisë është shumë i rëndësishëm, siguri është edhe puna edhe angazhimet e qytetarëve në të gjitha fushat, dmth. për ne siguria përfshinë një spektër të gjerë të aktiviteteve. E përkrahu edhe propozimin që e dha Rexhep Gashi që të diskutojmë edhe për ditën e diele si ditë pushimi obligativ për punëtorët. Ndërsa të gjitha çështjet tjera mundën me pritë për ty shqyrtuar në ndonjë mbledhje tjetër të Kuvendit.

z.Shefki Dauti; Me sa po duket u keqkuptuam sepse askush nuk tha se dita e diel nuk është ditë pushimi. Ne thamë se po duam që ta konsumojmë debatin për këtë çështje, pastaj se far vendimi do të marrim për këtë varet nga votat e shumicës.

z.Rexhep Gashi; Unë kam fakte të mjaftueshme për këtë propozim që e bëra, sepse kam biseduar me shumë biznese dhe e kam pa se ata janë të interesuar që ditën e diel ta kenë ditë pushimi.

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Përshëndetje, duhet ta sqarojmë se secili dokument duhet me shkuar nëpër KPF-ë për shqyrtim. Sa i përket pikë së 5 të rendit të ditës “Raporti periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm” është Ligji Nr.05/L-055, për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, që na obligon që këtë raport ta qesim për shqyrtim në Kuvend. Sa i përket pikës shtesë “Propozim-Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2020” që e kemi propozuar të futet në rendin e ditës, mund të them se ne jemi për dy muaj mbrapa që është dashur që ta aprovojmë në Kuvend një Plan të tillë të Punës të KKSB për vitin 2020.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi propozimin e Nënkryetarit Rrahman jakupi që të futet në rendin e ditës si pikë shtesë edhe: “Propozim-Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2020”.**

*** Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi propozimin e Marigona Pajazitit që te pika e 6 Lista e Kërkesave të diskutohet edhe për: Formimi i Komisionit për ndryshimin e rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Studentë.**

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi rendin e ditës me pikën shtesë: “Propozim-Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2020” si dhe te pika 6 “Lista e Kërkesave” të diskutohet edhe për**

Formimin e një Komisionit për ndryshimin e rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Studentë.

Pika 1

Shqyrtimi i ekstrakt procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 30.01.2020

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Fehmi Hysenaj; Te pika e 5 ku e kemi pas Raportin e Punës së Kuvendit për vitin 2019 unë nuk kam thënë kështu siç është shkruar “Pastaj duhet të rregullohet edhe çështja e transmetimit të mbledhjeve sepse nuk po shihet mirë”, por kam thënë “Kjo mënyra në Facebook si është nuk është në rregull, sepse nuk shihet figura e personit i cili flet, dhe do të ishte mirë që ne të ndërmarrim masa që mbledhjet të transmetohen në Televizion, por nëse ne nuk kemi mjete për ta paguar televizionin, unë po kërkoj që me mjete tona të bëhen incizime dhe pastaj më vonë mund të shfaqen në Ueb-faqe”.

z.Rexhep Gashi; Te pika e 6 unë kam diskutuar dhe i kam numëruar projektet që janë dështuar e disa janë keq menaxhuar e nuk i kam bërë krahasim por i kam cekë cilat projekte kanë dështuar, cilat projekte nuk kanë pas emërtime e që nuk janë shkruar në procesverbal.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi ekstrakt procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 30.01.2020.**

Pika 2

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Milot Deliu; Pyetja ime e parë i adresohet Drejtoris së Arsimit znj. Agime Hasani dhe Drejtorisë së Shëndetësisë z.Labinot Beqa. Ne e dimë që Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSH), bazuar në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik (IKSHP), kanë shpërndarë nëpër shkolla materiale vetdijësuese rreth korona-virusit, kjo është bërë e ditur përmes një komunikate të martën. MASHTI u ka kërkuar drejtorive komunale të arsimit, që orët e para të mësimit t’i kushtohet këtij virusi, përkatësisht nxënësve t’u mësohen masat parandaluese, bazuar në udhëzimet e Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik. Po ashtu MASHTI i ka udhëzuar DKA-të që t’i pajisin shkollat me material higjienik dhe të gjitha institucionet shkollore të bëjnë dezinfektimin e shtuar të gjitha sipërfaqeve dhe nyjave sanitare.

Për shkak të gjendjes alarmante dhe tejet shqetësuese kërkoj mirëkuptimin e kryesueses dhe të gjithë kolegeve në Kuvend, për hire të transmetimit të drejtpërdrejt që e kemi, që t’ju mundësohet dy drejtorive, që tani të na japin nga një informacion 5 minutash mbi gatishmërinë e tyre për t’i shpjeguar ne detaje përgatitjet e këtyre drejtorive dhe mënyrën se si do të qasemi si nivel komunal parandalimit ose menaxhimit të këtij problemi.

Drejtoresha e Arsimit është mire të na njoftoj se cili është plani veprues dhe ne far intervali kohor mendon të përfundoj projektin e dezinfektimit të gjitha shkollave dhe cilat janë ekipet apo kompanitë të cilat do të angazhohen ?

Si kanë funksionuar ekipet ligjëruese dhe nga far profesionist janë ligjëruar ?

Sa është sasia e materialit higjienik dhe kush do ta beje shpërndarjen në të gjitha shkollat e komunës ? Drejtori i Shëndetësisë a është i informuar për mungesën e materialeve sidomos maskave mbrojtëse në barnatoret e komunës sonë, dhe a ka pasur një plan mobilizimi, meqenëse paralajmërimet kanë qene me kohe ?

A ka informacione nga QKMF-ja mbi numrin e vizitave të pacientëve me simptoma të gripit muajin e fundit dhe ky numër a është në rritje ?

z.Skender Hyseni; Përsëritje, unë kam një pyetje për DZHE, Rrugët e arave që kanë mbetur pa u përfunduar gjatë vitit të kaluar që janë shtruar me zhavorr, kërkoj që drejtori të na njoftoj së paku se a do të ketë tash fillimin për vazhdimin e këtyre rrugëve dhe kurë do të përfundohen, këto rrugë të arave?

z.Fehmi Hysenaj; Në disa mbledhje radhazi që kam bërë shumë pyetje e që nuk kam marrë përgjigje, ky pra është një shqetësim i imi që po e paraqes. Unë po kërkoj nga Drejtoria e Prokurimit, që të na e sjellë listën e operatorëve ekonomik me vendin e saktë prej nga vijnë operatorët të cilët kanë marrë projekte në komunën tonë, dmth. për shumën e projekteve që kanë marrë dhe mjetet financiare? Pyetje për DPUKGJ, a janë shkelur dispozitat e Ligjit për ndërtim Nr.04/L-010 në dhënien e kushteve për ndërtim te pallatet ku është edhe pallati i Kryetarit, dmth. te të gjithë kompleksi i pallateve atje? Po kërkoj nga DPUKGJ që të na ofroj listën e investitorëve të këtyre pallateve, si dhe shuma e paguar për leje të ndërtimit për secilin objekt? Pyetje tjetër për DPUKGJ, kush e ka bërë pranimin teknik të projekteve për ndërtimin e parqeve nëpër fshatra të cilat më së paku mund të quhen parqe? Pyetje e radhës është për DPUKGJ, se çka u bë me këtë ngjyrën e vendosur te Ura e madhe në Shtime? Pyetje për DKA, një shqetësim që e kam për shkak të mungesave të shumta që janë bërë sidomos te shkolla “Emin Duraku” çka do të bëhet me ato mungesa a do të zëvendësohen orët e humbura sepse është pikëpyetje se a do të realizohet edhe plan-program mësimor ?

z.Muhamet Ademaj; Pyetje për DKA, meqenëse në kohën e fundit ka filluar me të madhe largimi i nxënësve nga komuna e Shtimes për tu larguar jashtë Kosovës kjo si dukuri shqetësuese, a e keni numrin e saktë të atyre nxënësve se sa janë larguar nga komuna jonë? Pyetje për DSHP, pse KRU “Prishtina” nuk i furnizon me ujë të pijshëm Shkollën fillore “Bajram Curri” në Petrovë si dhe banorët e komunitetit rom në rrugën “Eqrem Çabej” në Shtime ?

znj.Adelina Beqaj; Pyetje për DSHP, objekti i cili ka qenë kërkesa për objektin e të pamës ka filluar të rrenohet, ju si drejtori bashkë me Inspektorat a keni qenë me e pa dhe a keni ndërmarrë diçka lidhur me atë? Pyetje për DPUKGJ, pse nuk është përfunduar akoma trotuari te Pishat? Pyetje për DSHMS, unë po dëshiroj me ditë se sa është e përgatitur QKMF-ja për sa i përket përhapjes së sëmundjes të Korona-virusit?

z.Ruzhdi Jashari; Shumë pyetje që po bëjmë nuk po marrim përgjigje. Pyetjet e mija kanë të bëjnë me çështjen e mbrojtjes së ambientit, mbeturina gjithkrah në hapësirat publike të komunës tonë. Edhe në mbledhjen e kaluar e kemi potencuar, Unë po kërkoj nga Drejtoria e Prokurimit që me na i dhënë listën për të gjithë operatorët ekonomik që kanë punuar në komunën e Shtimes për periudhën 3 vjeçare në përputhje me Kornizën Afatmesme Buxhetore, dmth. të gjitha adresat e tyre si dhe shumat që i kanë marrë? Nga DPUKGJ-ja Kërkoj të gjithë dokumentacionin komplet prej fillimit për banesat kolektive te “Fitorja” të kompletohen dhe të sillen në seancën e radhës së Kuvendit? Për DKA-në, sa punëtor të arsimit punojnë me gjysmë norme, duam ta dimë saktë numrin e tyre?

z.Herolind Selmani; Përshëndetje, unë kam një pyetje për Kryesuesen e Kuvendit, se pse nuk po e thirrë një mbledhje për Komisionin për verifikimin dhe destinimin e banesave komunale? Pyetje për DKA-në a ndiqet mësimi parashkollor në Lagjen e Pajtit dhe në Belinc, nëse po sa nxënës janë gjithësejt?

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Komuna e Shtimes është e përgatitur për sa i përket mbrojtjes ndaj Korona-virusit, kështu që banorët e komunës nuk kanë nevojë me pas brengë këtë çështje. Janë duke u mbajtur ligjëratat për mbrojtjen kundër këtij virusi dhe ne po i përcjellim me vëmendje zhvillimet në Kosovë. Në këtë sezon është e vërtetë që e kemi një grip sezonal por nuk e kemi numrin e saktë të sëmurëve. Material dezinfektues dje është shpërndarë nëpër shkolla.

znj.Arbresha Sylja; Përshëndetje, pak edhe për shkak të aspektit profesional e mora fjalën për këtë temë të korona-virusit, unë po them shkurt se janë marrë masa për organizimin e ligjëratave gjithandej për ti njoftuar qytetarët për masat mbrojtëse. Është e mirë që në Kosovë nuk kemi raste të infektuarve me këtë virus. E kuptoj se kjo është bërë mediatike mjaft shumë, por ajo që duhet thënë është se është mirë që të shmangen grupimet e njerëzve mirëpo vend për panik nuk ka.

znj.Marigona Pajaziti; Përshëndetje, unë kam një pyetje për DSHP-në se sa po respektohet Ligji për mospirjen e duhanit nëpër lokale në komunën e Shtimes?

Pika 3

Rishqyrtimi i Ligjshmërisë të Rregullores Komunale për Taksa, tarifa dhe Gjoha sipas MAPL-së

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Njoftoi Kuvendin me rekomandimin e KPF-së dhe në vazhdim për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ardita Ndrecaj.

znj. Ardita Ndrecaj, zyrtare kryesore financiare; Përshëndetje, kjo Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2020, është kthyer nga MAPL-ja për rishikim në Kuvend me qëllim që të përmirësohen disa nene të kësaj rregullore. (Shih dokumentin) Ne i kemi bërë ndryshimet e kërkuara sipas MAPL-së në fushën që e mbulon DSHP-ja si dhe në fushën që e mbulon DZHE dhe DSHMS. Ndryshimet i kemi të shkruara të cilat i kemi marrë dhe po besoj i kemi lexuar, e të cilat janë harmonizuar me Ligjet ashtu siç është kërkuar nga MAPL-ja. Unë nuk do ta zgjati më shumë, i mirëpresim pyetjet e juaja.

z. Perparim Ramusa; Faleminderit, meqenëse kjo pikë e rendit të ditës është për herën e tretë që vjen për shqyrtim në Kuvend, pastaj ka qenë edhe në debat publik, kështu që unë mendoj se ne si Kuvend dhe Komitetet për Politikë dhe Financa e kemi kryer punën tonë. Meqenëse administrata nuk i ka dërguar me kohë ndryshimet e mundshme ligjore, ashtu siç edhe kemi rekomanduar në Komitetet propozoj që të procedohen ndryshimet mundshme ligjore në MAPL-ë.

z. Naim Zejna; Kuvendi nuk ka bërë gabim me miratimin e kësaj rregullore, unë mendoj se këtu kemi një mosharmonizim të dispozitave mes Ligjeve. Kur neve na vinë propozimet nga ekzekutivi, secili drejtor që e bien propozimin për miratim në Kuvend, paraprakisht duhet të konsultohet mirë me Zyrtarin Ligjor për sa i përket bazës ligjore për propozimin që e bën.

z. Fehmi Hysenaj; Unë konsideroj se është shqetësim për ne fakti që na kthehen vendimet ose rregulloret nga MAPL-ja për rishikimin e tyre. Unë po kërkoj që paraprakisht drejtoritë të konsultohen mirë me Zyrtarin Ligjor. Por Zyrtari Ligjor duhet edhe neve këtu në Kuvend të na bëj me dije se nuk jemi në përputhje me Ligjin në rast se po bëhet miratimi i ndonjë dokumenti në kundërshtim me Ligjin.

z. Muhamet Ademaj; Unë e përkrahu rekomandimin e KPF-së, sepse faktikisht Ligji po na obligon për të bërë ndryshimet e nevojshme në këtë rregullore.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe dhe Gjoha për vitin 2020, Npi – 01/312 datë: 31.10.2019, si vijon:**

1. Neni 7.3, Largohet (hiqet) nga Rregullorja.

Sipas legjislacionit ne fuqi kjo është tani kompetencë e Institucioneve qendrore.

2. Neni 10.2 i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe dhe Gjoha për vitin 2020, Ndryshohet dhe bëhet si vijon: “Duke u bazuar në U.A. Nr.04/2007, të datës 24.09.2007, dhe U.A. Nr.04/2013 për Çertifikatat Shëndetësore i datës 15.05.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesa e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të instucioneve shëndetsore, çmimorja e pagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit paresor është”:

3. Neni 10.2.18, Largohet (hiqet) nga Rregullorja.

4. Neni 10.2.19, Ndryshohet shuma e pagesës nga: 18€ në 15euro.

5. Neni 13 i Rregullores për Taksa, Tarifa dhe dhe Gjoha për vitin 2020, ndryshohet teksti nga: “Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, marrjen e lejes për shfrytëzim” në: “Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheh masën ndëshkuese, për personat fizik, marrjen e lejes për shfrytëzim. Ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtjes me gjobë”.

Pika 4

Draft-Programi Komunal për banim për periudhën 2020-2022

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ibrahim Demiri.

z. Ibrahim Demiri, Përgjegjës i ZKKK; Përshëndetje, ne e kemi dorëzuar në formë të shkruar dokumentin që tani e kemi para veti. Ky dokument është kontinuitet i dokumenteve të kaluara. Unë po flas në emër të grupit që e ka hartuar programin për banim që jetojnë në kushte shumë të rënda sociale.

Unë po flas për 25 familje që i kemi identifikuar si familje me nevoja më të veçanta, ne i kemi vizituar këto familje së bashku me anëtarët e Komitetit për Komunitete. Unë mendoj se për zbatimin e këtij programi në mënyrë të suksesshme duhet të ndahet edhe një sasi e mjeteve nga Buxheti. Unë nuk do ta zgjati më shumë, meqenëse do të shkojë në diskutim publik, por i mirëpresim pyetjet dhe sugjerimet e juaja. (Shih dokumentin)

znj.Adelina Beqaj; E falënderoj zyrtarin për informacionet, edhe unë jam pjesë e grupit për hartimin e dokumentit, kështu që e di se çka është diskutuar dhe çka është punuar në këtë grup. Unë pajtohem plotësisht që këtyre familjeve duhet që tu ndihmohet, prandaj u bëj thirrje kolegëve që ta përkrahim këtë dokument.

z.Perparim Ramusa; E falënderoj Ibrahimin për prezantimin e këtij programi. Meqenëse ky program për banim po shkoja në diskutim publik, unë nuk do ta zgjati shumë, por kam një pyetje, meqenëse Komuna ka disa banesa në pronësi, pyetja është a janë përfshi edhe banesat e Komunës në këtë program?

znj.Fatmire Ferati; Përshëndetje, sa i përket këtij Plani tre vjeçar, është bërë një punë e mirë, pasi që edhe është bërë skanimi i gjendjes në teren. Ne si anëtarë të komitetit për Komunitete kemi dalë në teren dhe kemi pa nga afër gjendjen e këtyre 25 familjeve që janë identifikuar si familje në gjendje më të rëndë. E di që Kuvendi i ka ndarë 25 ari tokë te Lagja e Pajtimit, kështu që unë mendoj se është mirë me e bërë një kërkesë në qendër për ndërtimin e një banese kolektive aty. Nëse nuk ka mundësi për ndërtimin e një banese kolektive atëherë të ndihmohen në shtëpi individuale.

z.Naim Zejna; Një pjesë të diskutimit që desha ta them unë veç e tha Fatmirja. E falënderoj Ibrahimin për prezantimin e këtij programi. Pajtohem që ky program të shkojë në diskutim publik. Unë kam një pyetje, a dihet sipas programit se sa do të jetë vlera e qirasë? Pastaj unë jam i mendimit se edhe banesat në pronësi të Komunës duhet të shfrytëzohen për rastet sociale.

z.Ruzhdi Jashari; E falënderoj Ibrahimin për prezantimin e këtij programi. E kemi pas një pasqyrë pak a shumë, mirëpo tani e kemi edhe gjendjen faktike për sa i përket pagesave të qirasë. Në anën tjetër bien në sy çështja e keq-menaxhimit, dhe për këtë keq-menaxhim, nuk është fajtorë Kuvendi por Ekzekutivi. Këtu para ndërtesës së Komunës i kemi katër banesa në pronësi të Komunës, pastaj kemi banesa edhe te banesat kolektive të "Fitorja". Në anën tjetër kemi 25 kërkesa urgjente për banim, e ne i mbajmë banesat e mbyllura. Grupi ynë parlamentar i Vetëvendosjes, disa herë kemi kërkuar debat për këtë temë.

z.Isak Muslija; Përshëndetje, unë mendoj se është shqetësues fakti se të njëjtat probleme me rrotacion po sillen që shumë vite e nuk po zgjidhen. Në vitin 2014 kemi diskutuar për një vendim që të ndahen 25 ari për çështje të banimit për skamnorë, ku ka qenë në pyetje a po vendoset në Gjyrkovc a në lagje të Pajtimit. U vendos në Lagjen e pajtimit, mirëpo prej atëherë asnjë veprim më tutje nuk është ndërmarrë. Është këtu edhe një problem sepse nuk e dimë se si është ndikimi te Plani Rregullativ i Komunës. Qe dy muaj po e presim një thirrje për mbledhje, ne anëtarët e Komisionit për verifikimin e Banesave, që është themeluar nga ky Kuvend. Unë mendoj se për një muaj kemi mundur me i rehatuar këto familje, përkohësisht është fjala. Prandaj unë mendoj se kjo temë është mjaft shqetësuese.

z.Rexhep Gashi; E përshëndeti grupin punues që e ka hartuar këtë program. Në vitin 2014 i kemi 17 familje që nuk u është bërë asnjëherë zgjidhje.

z.Muhamet Ademaj; E falënderoj Ibrahimin për prezantimin e këtij programi. E drejta për banim është e drejtë elementare. Në komunën e Shtimes na tha Ibrahim se janë 60 familje që kanë nevojë për banim. Ne si anëtarë të Komitetit për Komunitete kemi dalë në teren dhe kemi pa se 18 familje janë në gjendje të rëndë.

z.Ibrahim Demiri, Përgjegjës i ZKKK; Unë si udhëheqës i grupit punues, në punën tonë si grup nuk kemi gjete se në komunën e Shtimes ka banesa për banim kolektiv legal. Qiraja do të jetë sipas kritereve që do të përcaktohen.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 20 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Kuvendi Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Programin Komunal për Banim për periudhën 2020-2022, në afatin prej 15 ditësh. Bartëse e**

procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shëndetësi, dhe Mirëqenie Sociale në bashkëpunim me Zyrën për Informim.

Pika 5

Raport periodik për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të përgjithshëm

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Ardita Ndrecaj.

znj. Ardita Ndrecaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Përshëndetje, Në Komunë është formuar grupi punues që ka mbajtur takime të rregullta dhe e ka analizuar raportin e Auditorit të përgjithshëm ku ka identifikuar 17 të gjetura. Shumica e të gjeturave veç janë përmbushur. Unë nuk do ta zgjati shumë meqenëse dokumentin e keni në formë të shkruar, nëse ka ndonjë pyetje do të mundohem të jap përgjigje. (Shih dokumentin)

z. Ruzhdi Jashari; Çështjet e Komunës janë nën thjerrëzën e Auditorit të përgjithshëm. kemi rekomandime të cilat nuk janë përmbushur vit pas viti dmth. që nga viti 2017, 2018 tani edhe 2019. Këtë vit qenkan identifikuar 7 të gjetura kjo nënkupton 17 shqetësime ose parregullsi. Këtë raport nuk ka nevojë me e miratuar Kuvendi sepse përgjegjës është Kryetari i Komunës. Kuvendi duhet me pas një plan veprimi, dhe duhet pastaj me shikuar zbatimin e Ligjit dhe vendimeve të Kuvendit që duhet të bëhen nga Ekzekutivi. Të gjetura janë 7 që nuk janë zbatuar, 6 prej këtyre të gjeturave janë që janë kryer pa zotim, kjo është më e rëndësishmja dhe më shqetësuese, prandaj ky raport i Auditorit me këto të gjetura duhet me shkuar në Prokurori të shtetit.

z. Fehmi Hyesenaj; Unë po e lexoj nenin 23 pika 5 e Ligjit, ku thotë që për të gjeturat e Auditorit të përgjithshëm në Kuvend silltet vetëm sa për informim të Kuvendit dokument në formë të përgjigjes, e jo si raport për aprovim. Tjetër vërejtje unë kam se nuk thuhet që 50% janë ndërmarrë masat por thuhet se janë marrë masa pjesërisht. Unë ju them kolegëve që këtë dokument ta marrin si përgjigje, e jo që ta votojnë si raport.

Nënkryetari, z. Rrahman Jakupi; Dokumenti që ja kemi ofruar Kuvendit është i bazuar në Ligjin Nr.05/L-055. (Në vazhdim lexoi nenin 5 të këtij Ligji) Ky dokument që sot ju ka ofruar Kuvendit, është edhe një hap më shumë drejt transparencës, kështu që unë mendoj se Kuvendi është mirë për me kërkuar edhe më shumë dokumente të tilla, për sa i përket transparencës, e jo me e refuzuar si të tillë, nga frika se mos po përzihet edhe Kuvendi në të gjeturat e Auditorit të përgjithshëm. Opinioni i Auditorit të përgjithshëm është “I pa Kualifikuar”, që nënkupton raport i mirë.

z. Shefki Dauti; Auditorin ne duhet ta kuptojmë si ndihmës ose këshilltarë. Unë kam një pyetje, se cilat rekomandime të Auditorit në cilin nivel janë përmbushur dhe cilat rekomandime kanë mbetur pa u përmbushur, dmth. a ka ndonjë rekomandim që deri tani është përmbushur tërësisht, dhe cilat janë përmbushur pjesërisht.

znj. Ardita Ndrecaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Sa i përket pyetjes së Ruzhdi Jasharit, fillimisht nxirret plani i veprimit, pastaj edhe jemi bazuar në rregulloren të cilën edhe e kemi ofruar në Kuvend. Të gjitha këto të gjetura janë të natyrës operative. Secili anëtarë i Komisionit ka punuar në mënyrën e vet. Unë e përmanda pak më parë se sa rekomandime janë zbatuar tërësisht e sa prej tyre janë zbatuar pjesërisht.

z. Naim Zejna; Ne e kemi kërkuar këtë informatë. E përkrahu raportin, sido që të jetë unë i kam rezervat e mia.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

* Kuvendi i Komunës, me 12 vota ”Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 6 vota “Abstenim” aprovoi Raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm për vitin 2019.

Pika 6

Lista e Kërkesave

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Lexoi kërkesat:

1. Kërkesa e z. Arsim Hajrizi, nga Shtimja, i cili në emër të 17 familjeve që jetojnë në segmentin e Rrugës “Adem Jashari” ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes që kjo pjesë e rrugës

“Adem Jashari” në drejtimin Shtime-Lipjan, të emërtohet me një emër, sepse nuk ka as emër e as numra të shtëpive.

Pastaj Kryesuesja lexoi Rekomandimin e DPUKGI-së dhe të KPF-së, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

z.Shefki Dauti; Ne si grup parlamentar i PDK-së jemi që kjo kërkesë të shkojë për shqyrtim në Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, sepse mund të kemi edhe kërkesa të tjera.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 21 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 27.02.2020, unanimisht vendosi që kërkesa, me numër Nr.01-070/05-2666/20 datë:30.01.2020, e Arsim Hajrizit, nga Shtimja të transferohet në Drejtorinë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, dhe të shqyrtohet sipas Udhëzimit Administrativ Nr.14/2019 dhe Udhëzimit Administrativ 17/2019 të cilët rregullojnë procedurën e emërimit dhe numërimit të rrugëve.**

2. Kërkesa e z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z.Kemajl Ademaj, Kërkesa Nr.01-070/05-1225/20 datë:16.01.2020, i cili në emër të z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, këmbimin e pronës së pa luajtshme që i është marrë nga Komuna me rastin e hapjes së rrugës Petrovë-Llanisht, në pjesë të Ngastrës Kadastrale Nr.985-2 Z.K-Petrovë, vendi i quajtur “Arat e Hoxhës” me sipërfaqe prej 699 m², si dhe pjesë të Ngastrës Kadastrale Nr.118-2 Z.K-Petrovë, vendi i quajtur “Rrahishtë” me sipërfaqe prej 154 m².

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi Rekomandimin e Zyrtarit Ligjor dhe të KPF-së, dhe në vazhdim hapi diskutimin për këtë kërkesë.

z.Isak Muslija; Unë nuk e di pse po lexohen vendimet Gjyqësore që nuk janë kontestuese. Nuk e di se a e din Ekzekutivi se sa prona u janë uzurpuar banorëve të komunës tonë e që nuk janë kompenzuar, ka raste me dhjetra ose qindra, qoftë te shtrati i Lumit Shtimjanja qoftë te asfaltimi i rrugëve. Unë kam kërkuar ndarjen e një pjese të buxhetit për këtë destinim, dhe nuk është bërë asgjë. Kemi raste të pa kompenzuara te Puset e Ujësjiellit që janë bërë shumë vite pa u kompenzuar pronarët e tokave. Pastaj e kemi edhe rastin te varrezat e dëshmorëve e veteranëve, këto informacione po i përmendi me qëllimin e mirë që Ekzekutivi në të ardhmen mos të gabojë. Unë jam që të kompenzohen por që të gjindet mënyra.

z.Fehmi Hysenaj; Me të drejtë Kuvendi ka kërkuar material shtesë për këtë kërkesë e që na e ka sjellur Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, por ka bërë një dallim. Ne jemi të obliguar që ta zbatojmë Ligjin, ndërsa e drejtë e qytetarit është që të kërkojë nga Komuna kompenzimin për pronën e uzurpuar, po ashtu e drejtë e tij është që edhe ta padisë në Gjykatë, Komunën për uzurpime. Por edhe Komuna është e obliguar që ta ruaj pronën publike dhe ti padisë në Gjykatë të gjithë uzurpatorët, që ta kthejë pronën publike. Unë kam vërejtje te rekomandimi i Zyrtarit Ligjor i cili nuk ka dhënë për Kuvendin një rekomandim të qartë. Sipas Ligjit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim dhe këmbim, te pika 5 nuk janë plotësuar kriteret sepse ky nen thot se Komuna duhet të sjellë në Kuvend vlerësimin e pronës që do të këmbëhet. Unë po kërkoj që kjo mënyrë e uzurpimit të pronës publike mos ta sjellë Komunën para një akti të kryer për këmbim. Unë po kërkoj që kjo kërkesë të shtyhet, kështu që nëse nuk shtyhet unë do të votoj kundër.

znj.Adelina Beqaj; E përkrahu diskutimin e Isak Musliut. Vlora e tokës që është uzurpuar nga parashtruesi i kërkesës që po kërkon ta këmbëjë, me vlerën e tokës që po kërkon ta këmbëjë nuk është e baraz-vlefshme. Nëse kjo bëhet unë mendoj se mund të nxitë kërkesa të reja por edhe mund të shkaktojë ndonjë konflikt në mes banorëve për rreth.

z.Reshat Mujota; Siq edhe e dini Kuvendi është për me i zgjidhë problemet e qytetarëve. Unë e shoh se këtu i kemi dy uzurpime, edhe pala por edhe Komuna. Unë po kërkoj nga Zyrtari Ligjor që të na jep një sqarim të qartë se si të vepron në këtë rast.

z.Ruzhdi Jashari; Nuk është pra kjo hera e parë që kemi dhënë pronën Komunale në shfrytëzim jasht ligjshëm, pastaj përveq kësaj edhe ja kemi dhënë me vlerë më të madhe mbi tre fish. E dimë se si janë bërë këto gjëra përpara, por tani nuk guxojmë që të lejojmë që të na përsëriten gabimet. Unë nuk jam

kundër që palës ti kompenzohet prona e tijë, por nga Zyrtari Ligjor i cili qenka këtu, po kërkojmë një sqarim të plotë i cili nuk shkon në kundërshtim me Ligjin. Nëse kjo qështja e kompenzimit shkon në dëm të fshatit ne jemi kundër.

z.Shefki Dauti; Edhe unë kërkoj një interpretim për këtë kërkesë nga Zyrtari Ligjor, pra ta dëgjojmë një herë Zyrtarin Ligjor e pastaj të vendosim.

z.Isak Muslija; Replikë, më se 99% për këtë rast ka të hapur procedurë gjyqësore. Unë e di se më parë në këtë far prone ka pasur njëfar konflikti mes disa banorëve. Unë vetëm një pyetje e kam për ekzekutivin, se a duhet të epet llogari për uzurpimet e bëra apo duhet të shpërblehet uzurpatori me këmbim ponash, këte tregomna .

z.Lulzim Muharremi, Zyrtar Ligjor; Bahri Rexhaj, si parashtues i kësaj kërkesë ka hapur një rast të kontestit gjyqësor për këtë pronë. Komuna e Shtimes e ka asfaltuar rrugën ekzistuese që ka ekzistuar që nga viti 1958, por jo në formën arbitrare. Mirëpo është e vërtetë që është pronë e Bahri Rexhaj. Unë në Gjykatë kam thënë se në këtë rast ka uzurpime të dy anëshme. Ai pastaj ka kërkuar nga Gjykata që ta pezullojë procedurën gjyqësore me arsyetimin që ti mundësohet Komunës që të provojë të gjej një zgjidhje lidhur me kompenzimin e pronës së uzurpuar.

z.Perparim Ramusa; Pas debatit që u zhvillua këtu në Kuvend, unë po kërkoj që kjo kërkesë me u shty me arsyetimin që të kemi informacione më të plota lidhur me këtë kërkesë. Unë jo që nuk po dua që ta kompenzojmë këtë pronë, por po dua që mos të fusim konflikt në mes banorëve. Ne jemi të obliguar që ta kompenzojmë këtë pronë por vetëm po dua që mos ta bëjmë me nguti këtë punë.

z.Milot Deliu; Këtu u pa se paskemi uzurpime të dy anëshme. Vlerësimi qenka bërë 25.000€. pyetja ime është nëse ne e kompenzojmë për pjesën e pronës së tijë, a do të kërkojmë edhe ne kompenzim ose lirimin e pronës së uzurpuar komunale?

z.Skender Hyseni; Shkurt, meqenëse po bëhet fjalë për fshatin Petrovë ku kemi pas probleme të ngjajshme me pronat publike, unë po kërkoj nga Ekzekutivi por edhe nga kolegët delegat këtu që mos të ngutemi të marrim vendim e të bëjmë zgjidhje të keqe.

z.Fehmi Hysenaj; Po shihet që kemi pas planifikim të dobët. Zyrtari Ligjor nuk na dha spjegimet e duhura dhe të qarta, edhe drejtoresha nuk është prezent në mbledhje, pra po shihet qartë mos-interesimi i ekzekutivit për ta zgjidhur këtë qështje. Kriter tjetër pra është edhe fakti që prona që kërkohet të këmbëhet duhet të jetë afër pronës komunale, si dhe të bëhet vlerësimi i pronës e që në këtë rast nuk i kemi. Këto duhet ti sjellë Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.

znj.Adelina Beqaj; Ne të gjithë këtu nuk e dimë se ku gjinden këto prona, për këtë arsye unë po kërkoj orto-foto dhe skica me ngjyra dhe të sqarohen mirë nga drejtoria se ku gjinden këto prona. Pasi të dimë me saktësi se ku gjinden këto prona dhe të plotësohen të gjitha kriteret e parapara me ligj ne mund të marrim një vendim adekuat.

z.Shefki Dauti; Të gjitha diskutimet dhe argumentet po flasin për nevojën që kjo kërkesë të shtyhet, me qëllim që mos të krijojmë raste precedan.

z.Ruzhdi Jashari; Komuna nuk guxon me pas epitetin e uzurpatorit, nëse kjo ka ndërtuar rrugë me interes publik. Interesi publik nuk është njësoj sikurse interesi personal, këtë duhet ta spjegojë Zyrtari Ligjor. Procedurat Ligjore duhet të interpretohen mirë sepse janë shumë delikate, ato edhe mund të prodhojnë konflikte në vend që të bëhet zgjidhje për një qështje të caktuar. Ne duhet po ashtu të kemi kujdes që me vendimt tona mos ta fusim Kuvendin ose qytetarët në konflikt.

z.Lulzim Muharremi, Zyrtar Ligjor; Në pyetjen e Milotit se a mundemi ne me e paditur palën uzurpatore. Përgjigja është po ne mundemi me ngritë padi në Gjykatë ndaj secilit uzurpator, pasi të jenë përfundura procedurat administrative. Sa i përket diskutimit të Ruzhdiut, unë mund të them se fjala uzurpim ekziston në Ligj dhe thot që kushdo që e merr ose përvetëson pronën e huaj në kundërshtim me Ligjin konsiderohet uzurpim.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më 27.02.2020, me 4 vota "Për" me 10 vota "Kundër" dhe me 4 vota "Abstenim" nuk aprovohet**

Rekomandimi i KPF-së që kërkesa e z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, me numër Nr.01-070/05-1225/20 datë:16.01.2020, të aprovohet, sipas rekomandimit të Zyrtarit Ligjor.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më 27.02.2020, me 14 vota "Për" me 2 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim" vendosi që kërkesa Nr.01-70/05-1225/20 e datës: 16.01.2020 e Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, të shtyhet për shqyrtim, me arsyetimin që Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi të ofroj për Kuvendin informacione shtesë për këtë kërkesë.**

3. Kërkesa (Shtesë) e znj.Marigona Pajaziti, Kryesuese e Komitetit për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport, e cila ka kërkuar nga Kuvendi që të futet si kërkesë shtesë në Listën e kërkesave Npi – 01/03 datë:18.02.2020 formimi i një Komisioni prej 5 anëtarëve për të hartuar ndryshimet në Rregulloren Komunale për ndarjen e bursave për studentë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për arsyetimin e kësaj kërkesë ja dha Marigona Pajazitit.

znj.Marigona Pajaziti, Kryesuese e KAKRS; Ne edhe në mbledhjen e fundit të Komitetit për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport të mbajtur më 26.02.2020 i kemi propozuar Kuvendit që të formojë një Komision prej 5 anëtarëve, dy anëtarë nga kuvendi dhe 3 anëtar nga ekzekutivi për të filluar hartimin e një drafti për ndryshimin e Rregullores komunale për ndarjen e bursave për studentë. Kërkoj nga Kuvendi që ta përkrahë propozimin tonë.

z.Ruzhdi Jashari; Së pari ne duhet ta kemi një arsyetim se pse po kërkohet që të ndryshohet kjo rregullore.

z.Shefki Dauti; Ne në KAKRS-së kemi marrë iniciativë për të bërë disa ndryshime në rregulloren për bursa me arsyetimin që duke e pa se bursa më shumë po marrin studentët nga fakultetet private se sa publike. Është shumë i vërtetë fakti se studentët në fakultet private e kanë shumë më të lehtë mundësinë që të marrin nota më të larta se sa në fakultet publike, kështu që edhe notën mesatare e kanë më të lartë, e me këtë edhe mundësinë për të përfitur bursën e kanë më të madhe. Këtu pastaj duhet ti shtohet edhe fakti se në fakultetet private në shumicën e rasteve shkojnë studentët që i kanë kushtet ekonomike më të mira se sa ata që janë rexhistruar në fakultet publike. Pastaj me këto bursa ne po dëshirojmë që të stimulojmë studentët që të shkojnë në drejtime shkencore, natyrore e më pak në ato shoqërore.

znj.Zarife Rexhaj; Ne nuk kemi kurrfar material për këtë pikë. Për këtë arsye unë fare nuk e kam të qartë arsyetimin dhe qëllimin e sajë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sqaroi lidhur me pyetjen e Zarife Rexhaj.

z.Perparim Ramusa; Kemi një kërkesë nga Kryesuesja e Komitetit për Arsim për fillimin e procedurave për ndryshimin e rregullores për ndarjen e bursave për studentë. Unë e përkrahu këtë kërkesë dhe jam që ta procedojmë tutje. Propozoj që fillimisht ta votojmë qelësin e formimit të komisionit.

z.Reshat Mujota; E tha Perparimi, ne në KAKRS-ë të gjithë e kemi votuar formimin e këtijë Komisioni. Kemi propozime që të kemi një diferencë te nota mesatare që arrihet te fakultetet private me ato në fakultetet publike. Unë jam "për" dhe kërkoj që të qitet në votim formimi i këtijë Komisioni.

znj.Fatmire Ferati; Unë kisha kërkuar nga Komisioni që me pas kujdes Ligjin sepse Ligji i ka të barasvlefshme univerzitetet private me ato publike.

z.Fehmi Hysenaj; Komiteti nuk duhet të vendosë për anëtarët e Komisionit. Unë jam "për" por fillimisht të del në diskutim publik.

z.Naim Zejna; Komiteti mundet me dhënë rekomandime, dhe unë jam për formatin prej 5 anëtarëve që të jetë Komisioni. Unë po e propozoj Zarife Rexhaj.

z.Isak Muslija; Unë jam "për" themelimin e këtijë Komisioni, mirëpo nuk jam me mënyrën e propozuar të Naim Zejna.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fillimisht lexoi propozimin e Marigona Pajazitit që Komisioni të jetë prej 5 anëtarëve, dy anëtarë nga kuvendi dhe 3 anëtar nga ekzekutivi. Në vazhdim konstatoi Kuorumin, prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje

*** Kuvendi i Komunës, me 12 vota "Për" me 3 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim" vendosi të aprovoi propozimin e Marigona Pajazitit që Komisioni të jetë prej 5 anëtarëve, dy anëtarë nga kuvendi dhe 3 anëtar nga ekzekutivi.**

z. Perparim Ramusa; Unë e propozoj Shefki dautin dhe Besnik Seferin.

z. Naim Zejna; Është mirë që parafolësi ta tërheq propozimin e dytë sepse nuk është nga Vetvendosja. Kështu që unë e propozoj Zarife Rexhaj.

z. Fehmi Hysenaj; Unë e propozoj Ruzhdi Jasharin.

z. Reshat Mujota; Unë mendoj se mirë është me lënë si propozim të LDK-së edhe Besnikun nuk ka problem, le të hyjë në vota dhe ta shohim a po vendoset.

z. Ruzhdi Jashari; Unë që në fillim e thash që ne nga subjekti politik i Vetvendosjes e propozojmë që të jetë Besnik Seferi.

z. Nim Zejna; Vijnë njerëz nga Prishtina këtu në mbledhjen e Kuvendit dhe ju diskutoni populizma kjo nuk është mirë. Unë mendoj se nuk ka kurgjë të këse edhe nëse propozohet nga një subjekt tjetër, nëse kalon mirë nëse jo kurgjë kërkujt.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 13 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2020, të mbajtur më 27.02.2020, me 8 vota "Për" me 3 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim" aprovoi vendimin për formimin e Komisionit për ndryshimin e rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Studentë Nr.01-06/570-60 të datës: 30.03.2012, prej 5 anëtarëve (dy nga Kuvendi dhe 3 nga Ekzekutivi) në këtë përbërje:**

1. Shefki Dauti - Përfaqësues nga pozita,
2. Besnik Seferi - Përfaqësues nga opozita,
3. Agime Roshaj - Drejtore e DKA,
4. Besnik Shala - Zyrtar i personelit në DKA,
5. Fatmir Zymeri - Zyrtar për financa në DKA.

Pika 7 (Pikë Shtesë)

Propozim-Plani i Punës së KKSBB-së për vitin 2020

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Rrahman Jakupit.

Nënkryetari, z. Rrahman Jakupi; Përshëndetje, unë nuk do ta zgjati shumë diskutimin tim, meqenëse Planin e Punës së KKSBB-së për vitin 2020 e keni marrë në formë të shkruar dhe e keni para veti. Prandaj nëse ka pyetje ne i mirëpresim. Ju ftoj që të aprovonit vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik Propozim-Plani i Punës së KKSBB-së për vitin 2020.


z. Fehmi Hysenaj; Unë po propozoj, që të shkojë në diskutim publik dhe mos ta zgjasim.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi Kuorumin, prej 13 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimisht aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Propozim-Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020 në afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra e Kryetarit në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Pasi që diskutime tjera nuk kishte Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 12.43h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

